



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN
E

ORGANIZUAR
KËSHILLI I GJYKATËS

Nr. Prot.

Tiranë, më u_î_. /0.2024

VENDIM

Nr. 10, datë 15.10.2024

"Mbi rezultatet e verifikimit paraprak për lëvizjen paralele në kategorinë e ulët drejtuese "Kryesekretar/e"

Këshilli i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, i përbërë nga:

Saida DOLLANI Kryetar
Dhimitër LARA Anëtar Elka DAJÇI
Anëtar

asistuar nga sekretare Fabjola Kushe, në mbledhjen e datës 15.10.2024, në zbatim të nenit 6 "Procedura e verifikimit të kushteve të sigurisë përpara emërimit në detyrë" të ligjit 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", nenit 9 "Verifikimi paraprak" dhe nenit 42 "Procedura shitesë e verifikimit të kushteve të sigurisë" të Vendimit nr. 622 datë 10.12.2020 "Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor" të Këshillit të Lartë Gjyqësor;

duke vërejtur se, për pozicionin vakant të shpallur më datë 23.09.2024, "Kryesekretar/e" është paraqitur 1 (një) kandidaturë, nga znj. Greta Xoxe;

duke vërejtur se, mbi verifikimin e kushteve të përgjithshme për lëvizjen paralele të përcaktuara në shpalljen e vendit vakant, u evidentua se kandidatja Greta Xoxe i plotëson këto kushte;

duke vërejtur se, në kriteret e veçanta që kandidatët duhet të plotësojnë për tu kualifikuar për fazën e "Vlerësimit nga Këshilli i Gjykatës", sipas nenit 11 të Vendimit nr. 622, datë 10.12.2020 "Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor" të Këshillit të Lartë Gjyqësor, përfshihen dhe kushtet e sigurisë sipas nenit 6 "Procedura e verifikimit të kushteve të sigurisë përpara emërimit në detyrë" të ligjit 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar";

duke vërejtur se, kandidatët për nëpunës civil gjyqësor, për t'u caktuar apo punësuar në pozicionet pranë Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duhet të plotësojnë kriteret e veçanta siç dhe kushtet e sigurisë, për çka duhet të dorëzojnë pranë Këshillit të Gjykatës aktet shtesë që i bashkëlidhen kërkesës për kandidim sipas përcaktimit të nenit 41 të Vendimit nr. 622 datë 10.12.2020 "Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor";

duke vërejtur se, giatë fazës së verifikimit paraprak, në verifikim të rregullsisë së plotësimiit dhe dorëzimit të akteve nga kandidatja, sipas pikës 1 të nenit 41 të Vendimit nr. 622 datë 10.12.2020 "Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor", u evidentua se nga kandidatja Znj. Greta Xoxe, janë dorëzuar tre "Deklaratë e pasurisë dhe interesave private të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë", të dorëzuara në ILDKPKI më: 12.11.2020; 29/03/2023 dhe 11/05/2023, mirëpo nuk plotësuar dhe dorëzuar deklaratën e kontrollit të pasurive dhe të konfliktit të interesit sipas formularit "Deklaratë e pasurisë dhe interesave private të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë", sipas ligjit 95/2016 si dhe vendimit të cituar të KLG.J; për sa më sipër Këshilli i Gjykatës bazuar në nenin 42, pika 1, të Vendimit nr. 622 datë 10.12.2020 "Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor",

Vendos:

1. Kandidatja Greta Xoxe nuk kualifikohet për fazat e tjera të procedurës.
2. Ky vendim ti njoftohet kandidatës znj. Greta Xoxe.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Tiranë, 15.10.2024.

KËSHILLI I GJYKATËS

Anëtar/Kancelar


Kryetar
ZËVENDËSKRYETARI I GJYKATËS
Saïda DOLLANI


Elka DAJÇI

Anëtar/Gjyqtar
Dhimitër LARA
